

Syllabus i lëndës

Lënda: **Gjuhë turke I**

Programi i studimit: **Teologji**

Numri i ECTS kredive: **3 ECTS Kredi**

Niveli dhe lloji i lëndës: **Zgjedhore**

Kodi i lëndës: **212**

Fondi i orëve: **2+0**

VITI AKADEMIK: 2026 / 2027

Semestri: -II-

Mësimdhënësi i lëndës: **Dr. Selim Selimi**

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuritë bazë rreth historisë së gjuhës turke. Pas nxënies së alfabetit të gjuhës turke studenti merr njohuritë më të rëndësishme të fonetikës dhe të fonologjisë turke ku do të nxë njohuri për ndarjen e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve turke, theksi e rrokja me ç' rast do të jetë aftësuar për të lexuar drejt turqishten. Studentët do të mësojnë sistemin emëror të gjuhës turke me të gjitha kategoritë e tij si atë të gjinisë, të numrit, të përkatësisë, të rasave duke bërë krahasime me këto kategori të emrit të gjuhës shqipe. Më pastaj do të mësojë edhe mbiemrat, përemrat e numërorët dhe foljen ndihmëse *Imek* e cila u bashkangjitet fjalëve emërore me ç' rast edhe kryen funksionin e kallëzuesit emëror tek fjalitë emërore. Në këtë mënyrë do të zhvillohen shkathtësitë dhe aftësitë e studentëve që të mund të kuptojnë përdorimet e këtyre kategorive gramatikore duke u përpjekur gjithnjë të bëjnë krahasimin me ato të gjuhës shqipe. Do të aftësohen për të mundur të fillojnë të flasnin e të shkruajnë turqisht në përputhje me atë nivel që u ofron programi i këtij studimi. Qëllimi i ushtrimeve është që studentët të aftësohen për shqyrtim kritik të çështjeve dhe problemeve të trajtuara gjatë ligjeratave, e që kanë të bëjnë me fushën e kësaj lënde. Përpunohen tekste që kanë të bëjnë me tema të ndryshme.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të ligjeratave, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj karakteristikat e fonetikës, fonologjisë e të morfologjisë së gjuhës turke.

Të aftësohen të lexojnë dhe të shkruajnë drejtë në gjuhën turke.

Të mund të përkthejë tekstet e zgjedhura nga gjuha turke.

Të përshkruajë situatat e ndryshme jetësore dhe së paku të jenë në gjendje të konsultojnë literaturë profesionale në gjuhën turke.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave dhe ushtrimeve ku studentët do të stimulohen për diskutime interaktive, për konverzacion në gjuhën turke ku do të diskutohet praktikisht për atë mësim që është zhvilluar gjatë ligjëratës. Po ashtu do të mbahen seminare, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupe, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe të rezultateve të synuara në mësim.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: Köken Bakımından Dil Aileleri, Türk alfabesi, Türk alfabeleri.

Ünlüler: Ünlülerin ayrılması, Büyük ünlü uyumu, Ünsüzler, Ünsüzlerin sınıflandırılması, Selamlaşma tanışma

Java e dyte: Türkçenin Gelişim Evreleri, Ailemiz, Günler, renkler, Sayılar, Vücudumuz, Sıfatlar.

Java e trete: Şahıs zamirleri, Alıştırmalar, İyelik kleri, Aşağıdaki boşlukları örnekteki gibi uygun kelimelerle doldurunuz, kelimeler, Okuma anlama, Aşağıdakileri uygun iyelik ekleriyle eşleştiriniz, Aşağıdaki boşlukları doldurunuz.

Java e katert: *OKUL:* Sınıf içi eşyalar, Öğrenci araç ve gereçleri, Kim ? ve Ne ? Sayılar, İşaret zamirleri, İsimlerde olumsuzluk, Çokluk eki, Soru eki, Olumsuzluk eki, emir kipi.

Java e peste: Gün adları, Ders adları, Zaman ifadeleri, Var-Yok kelimelerinin kullanımı, İsmi bulunma hali, Ek – Fiil geniş zaman, ayı sıfatları.Soru sıfatları, Sıra s

Java e gjashte: Ev, Evin bölümleri, Ev eşyaları, İsim tamlaması, İsim yapım eki “li”, İsim yapım eki “-siz” .

Java e shtate: Testi - Kllokfiumi

Java e tete: Ülkeler: Ülke adları, Nereli olduünü söyleme, Nerede yaşadığını söyleme, Şimdiki zaman, “y” bağlayıcı ünsüzü, Şahıs ekleri. Folja jo e plotë *Imek* dhe funksioni I saj si kallëzues emëror.

Java e nëntë: Akrabalar: Aile fertleri, Aile fertlerinin yaşlarını sorma, Aile fertlerinin neredë yaşadığını sorma, Bağlaçlar “çünkü, ama, ve, da, de”.

Java e dhjete: Meslekler: Mesleklerle ilgili mekan adları, Mesleklerle ilgili fiiller, Eşitlik eki “-ca, -ce”, Ünsüz uyumu, Edatlar.

Java e njëmbëdhjete: Zaman: Saatlerle ilgili ifadeler, Zaman ifadeleri, Gelecek zaman, Ünsüz yumuşaması, İsmın yönelme hali, İsmın belirtme hali.

Java e dyymbdhjete: Meyveler sebzeler: Meyve ve sebze adları, Alışveriş mekanları,, Alışveriş ifadeleri, Görülen geçmiş zaman, Pekiştirme sıfatları, İkilemeler.

Java e trembëdhjetë: Yiyecekler içecekler: alışveriş ifadeleri, Zaman ifadeleri, Ek—fiilin görülen geçmiş zamanı, Belgisiz sıfatları, İsmın ayrılma hali.

Java e katërbëdhjetë: Yemekler: Yemek adları, İçecek adları, Tatlı adları, Geniş zaman, İstek kipi.

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier- Kollokfiuumi 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 81 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=71 – 80. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=61 – 70. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=51 – 60. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 50. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura themelore:

Dr.İbrahim Gültekin, Mahir Kalfa, İbrahim Atabey, Filiz Mete, Aydan Eryiğit, Uğur Kılıç, Yedi İklim Türkçe Ders kitabı A1 Başak Matbaacılık, Ankara 2017 ve Dr. Selim Selimi, Temel Türkçe Ders ve Çalışma Kitabı 1 , Pristine 2016

Literatura plotësuese:

1. Tahsin Banguoğlu, Türkçenin Grameri, Baha Matbaası, İstanbul, 1974.
2. Prof. Dr. Muharrem Ergin, Üniversiteler için Türk Dili, İstanbul, 1994.
3. Karaman N. Nihal, Yabancılar için Türkçe metinler, İstanbul, 1988.
4. Vecihe Hatipoğlu, Türkçenin Sözdizimi, Ankara 1982.
5. Gülden Sağol yüksekaya, türk Dili Kitabı, İstanbul, 2006.
6. Abdullah Hamiti. Gramatika e gjuhes se sotme turke. Prishtine, 2002.
7. Mehdi Polisi. Gramatika e gjuhes turke. Logos Shkup, 2009.
8. Gülden Sağol Yüksekaya, Türk Dili Kitabı, Duyap yayımları, İstanbul, 2006.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit, ç'kyçja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë\Javë | Gjithsej |
|------------------|-----|-----------|----------|
| Ligjërata | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime teorike | 0.5 | 7.5 | 7.5 |

| | | | |
|--|-------------|-------------------|-----------|
| Punimi seminarik | 4 | - | - |
| Kontaktime me mësimdhënësin\konsulltime | 0.5 | 7.5 | 7.5 |
| Ushtrime në teren | - | - | - |
| Kollokfiume, seminare, ese | - | - | - |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 2 | 2 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | - | - | 4 |
| Përgatitja përfundimtare për provim. | 5 | 5 | 8 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final) | - | - | 2 |
| Totali | (13) | (14 javë) | 50 |